

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR

"Safety Solutions Albania" SHPK



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK**

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "XXX" SHPK
KREU I**

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

Sot, më 19/07/2024 (dymijë e njëzet e kater), Ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Safety Solutions Albania " SHPK

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "Safety Solutions Albania" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2

SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane Sami Frasheri Qndra Metropol AP. 12 H 13., Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është e papërcaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekti i Aktivitetit


Objekti i Aktivitetit

Konsulence teknike ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune (ligji 10237 datë 18.2.2010 si dhe direktivave europiane ne kete fushë);certifikimit te ndermarrjeve e institucjoneve ISO 9001/ISO 14001/ISO45001;formim profesional per shendetin dhe sigurine ne pune; Konsulence subjekteve per ndihmen e pare dhe mbrojtjen nga zjarri sherbime te specializuara;ekspertize dhe/ose konsulence per



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK

punedhenes dhe punemares, subjekte private e publike per sigurine dhe shendetin ne pune me qellim: Parandalimin e rreziqeve per aksidentet ne pune dhe semundjet profesionale; vleresimin e rrishtit per cdo pozicion pune; mbrojtjes nga zjarri (sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi); mirembajtjes se fiksave dhe paisjeve te sinjalizimit te zjarrit (ne perputhje me normat teknike (ISO-EN); vleresimit te rreziqeve ne pune (rreziqet ne pune ne pergjithesi dhe mbi zhurmat, vibrimet, pluhurat, gazet e demshme, rreziku kimik, te kantierëve te ndertim-motimit, puna ne lartesi, stressi, etj ne vecanti); analizave kimike te ndotjes se ajrit, ujrave, tokes, mbetjeve industriale dhe urbane; regjistrimit te substancave kimike prane angjensise europiane te Helsinkit; klasifikimit, ambalazhimit dhe etiketimit te substancave te rrezikshme, perpilimit te skedave (formularve) te sigurise per substancat e rrezikshme (sipas Rregullores Komunitetit European CLP) Direktives Europiane "Seveso" per ndermarrjet qe prodhojne e deponojne produkte te rrezikshme, autokontrollit higjieno-sanitar dhe metodes HACCP (Hazard Analysis Control Points) ne fushen e manipulimeve te ushqimeve (restoranteve, fast food e tj.) dhe te sherbimeve te meposhteme: kolaudime te impjanteve dhe makinerive ngritese dhe transportuese, kolaudime te linjave teknologjike industriale. inspektime te gjendjes teknike te impjanteve dhe konstruksioneve teknologjike, kontrole difektoskopike te linjave dhe paisjeve teknologjike, inspektime te eneve nen presion. inspektime te terminaleve te naftes, kontrole te tegeleve te saldimit, spesoreve dhe kontrole te formes gjeometrike sipas standarteve, kalibrime te rezervuareve te cdo lloji, hartime te llogaritjeve dhe projektit teknik te mbrojtjes nga zjarri per cdo lloj impjanti. studime, projektme teknologjike dhe konstruksione metalike, pergatitje e informacioneve per impjante teknologjike te ndryshme, shit-blerje e dhenije me qira pronash te patundshme (imobilare), vleresime ekspertize tekniko-ekonomike te impjanteve teknologjike e konstruksioneve metalike, pergatitje te plan bizneseve ne fushen e industrise, pergatitje te oponenteve ne projektet teknologjike dhe terminalet e naftes, formim dhe trajnim profesional, formim dhe trajnim per sigurine dhe shendetin ne pune, mbrojtjen e ambientit etj, tregetim i mjeteve personale dhe kolektive, sinjalistikes per sigurimin teknik ne pune, makinerive dhe mallrave te llojeve te ndryshme si dhe ndertime civile. Formim per sigurine teknike ne pune per shofera piruni dhe makinash per levizjen e dheut. Formim per sigurine teknike ne pune te vinciereve. Formimin e drejtuesve te automjeteve per transportin e mallrave te rrezikshem (ADR). Formimin e pergjegjesit teknik per impjante perpunimi mbeturinash. 20 Formim per personelin e ndihmes se shpejte mjekesore. Formim per sigurine teknike ne pune te makinist dhe ndihmes makinist te trenave. Formim per sigurine teknike ne pune per kryetar treni dhe frenuesi. Formim per sigurine teknike ne pune per kryemanevrant dhe manevrist treni. Formim per sigurine teknike ne pune per kryetar treni dhe udhetarsh dhe shoqerues vagoni. Formim per sigurine teknike ne pune per mekaniket kontrollor dhe mekaniket e trenit te udhetareve. Formim per sigurine teknike ne pune per inspektoret e jashtem, te brendshem, nderruesit dhe rojtaret e kalesave. Formim per sigurine teknike ne pune per tekniket dhe brigadieret e linjes. Formim per sigurine teknike ne pune per rojtari binarit te hekurudhave. Formim per sigurine teknike ne pune per punetoret e mirembajtjes se hekurudhes. Formim per sigurine teknike ne pune per mekaniket e sektorit te mirembajtjes se hekurudhave. Formim per sigurine teknike ne pune per elektrikist sinjalizimesh te hekurudhave. Formim per sigurine teknike ne pune per minaretoret e nentokes. Formim per sigurine teknike ne pune per zjarmetar. Formim per sigurine teknike ne pune per gazmates. Formim per sigurine teknike ne pune per armator dhe nd/armator. Formim per sigurine teknike ne pune per punonjes transporti ne miniere. Formim dhe informim per sigurin teknike te operatorve/nd. Operatorve xhumos ose simbes. Formim dhe informim per sigurin teknike te operatorve te fadromes/ngarkuesit. Formim dhe informim per sigurin teknike te operatorve dhe nd. operatorve te pompave te betonit te sprucuar. Formim per sigurine teknike ne pune per punetoret mirembajtje dhe



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"

SHPK

ndihmes. Formim per sigurine teknike ne pune per elektrikist ne miniere. Formim per sigurine teknike ne pune per punetor ne minierat siperfaqesore (karierat). Konsulence ne fushen e shendetit ne pune ne kompanite private dhe shtetore nepermjet profesionit te mjekut te punes apo mjekut te ndermarrjes. Sherbime outsourcing/te jashteme te Pergjegjesit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune (Health and Safety Officer); Sherbime Outsourcing/te jashteme te Koordinatorit te Sigurise ne fazen e zbatimit; Monitorim e Pasurise Kulturore (Cultural Heritage Monitoring). Trajnimi i punemarresve qe punojne ne hapesira te kufizuara/mbyllura. Montim dhe cmontim skelerie. Instalime elektrike dhe zbatim i projekteve te impianteve elektrike. Zbatimi i projekteve hidraulike dhe kryerja e instalimeve hidraulike. Projektim dhe kryerja e instalimeve te projekteve HVAC .

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i Shoqërisë është 100.000 Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët të cilët perbejne 100 % (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- Z. **Bledar Rushiti**, shtetas shqiptar, lindur në Patos, dtl 05.04.1985, identifikuar me numër personal I50405034L dhe numër letërnjoftimi 0693769949 zotërues i një kuote, , me pjesëmarrje në përqindje 51 % me një kontribut prej 51. 000 (pesdhjet e nje mijë) Lekë;
- Z. **Ermir Shkoza**, shtetas shqiptar, i lindur në Kavajë, dtl 18.03.1985, identifikuar me numër personal I50318116M dhe numër letërnjoftimi 0693588067 zotëruese e një kuote, me pjesëmarrje në përqindje 49 % me një kontribut prej 49.000 (dzyet e nente mijë) Lekë;

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

Në rast se një ortak apo një bashkëzotërues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmit persona që do ti njihet titulli mbi kuotat nga Shoqëria; por asnjë nga keto

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK

parashikime nuk liron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

Personi i cili fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emrin e një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje.

Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruar i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotëruar i kuotës.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i parashkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK

Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 9

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesën e kapitalit që ai zoteron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverballi përkatës.


Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK

Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të çdo ortaku pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotëron më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statuti ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera nën administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti i interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë:

- Z. Bledar Rushiti, shtetas shqiptar, lindur në Patos, dtl 05.04.1985, identifikuar me numër personal I50405034L,



NENI 11

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) i përfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

KREU V

**KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË,
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENTI**

NENI 12

KONTROLLI FINANCIAR

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 13

VITI FINANCIAR

Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 14

BILANCI VJETOR

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë dhe llogaritë vjetore.

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK**

Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 15

DIVIDENTI

Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhes në të cilën paguhet dividendi.

KREU VI

PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM,

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 16

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 17

LIGJI I ZBATUESHËM

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e Shoqërive Tregtare.

NENI 18

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE


AKTI I THEMELIT DHE STATUTI I "Safety Solutions Albania"
SHPK

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Bledar Rushiti

Bledar Rushiti


Ermir Shkoza

Ermir Shkoza
